



Fatos Beqiraj ka arritur te shenoi golin e vetem per Dinamo Zagreb ne humbjen qe skuadra e tij arriti ne Odessa ndaj Chernomorets, nga ekipi ku aktivizohen dy shqiptaret Kristi Vangjeli dhe Elis Bakaj.

Beqiraj, shenoi ne minuten e 20-te te takimit, duke i dhene avantazhin provizor skuadres Kroate. Vendasit arriten te shenojne dy here ne 15 minutat e fundit tetakimit duke eliminuar perfundimisht Dinamon dhe mbajtur te hapura shpresat per skuadren Ukrainase te kualifikohet ne 32-she. Per Dinamon ne pjesen e dyte u aktivizua edhe Arjan Ademi.

Per Chernomorets nuk u aktivizuaasnjeri nga dy shqiptaret Kristi Vangjeli dhe Elis Bakaj (ne stol).

Berat Sadiku shenoi golin e vetem per skuadren e tij Thun ne humbjen ndaj Rapid ne Viene. Sadiku hyri si zevendesues ne minuten e 59-te kur Thun ishte ne disavantazh 0-1 dhe shenoi tre minuta me pas duke barazuar provizorisht rezultatin, por Boskovic, me golin e realizuar 2 minuta me vone i shkaterroi perfundimisht shpresat e Thun per nje kualifikim te mundshem ne fazen eliminatore.

Muhamed Demiri dhe Emir Lenjani u aktivizuan si titullare gjate gjithë takimit per St Gallen qe humbi 0-4 ne fushen e Kuban.

Lorik Cana dhe Etrit Berisha luajten si titullare gjate gjithë takimit ne fitoren qe Lazio arriti ne Poloni ndaj Legia me rezultat 2-0 duke siguruar kualifikimin midis me te mirave ne turin eliminator

Europa League/ Beqiraj dhe Sadiku golat shqiptare ne Evrope

nga AlbaniaSoccer

E premte, 29 Nentor 2013 07:04

Isli Hidi u paraqit si titullar per Apollon Limasol qe u shkaterrua 4-2 ne Turqi nga Trabzponsor. Kjo ishte ndeshja e dyte e portierit shqiptar ne keto eliminatore

Valon Berisha luajti 90-te minuta si titullar ne fitoren e Salzburg 1-0 ne fushen e Elfsborg. Skuadres Austriake i duhet te pakten nje pike ne ndeshjen e fundit qe te siguroje vendin si fituese e Grupit dhe nje kualifikim midis 32 me te mirave te UEFA Europa League.

Ergys Kace vazhdon te mos aktivizohet ne keto eliminatore per PAOK qe fitoi 2-0jashte fushe ne Kazakistan ndaj Shakhtar Karagandy duke siguruar nje vend ne fazen eliminatore. Per skuadren greke u aktivizua 83 minuta si titullar mesfushori Sotir Nini